



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME



Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural

Direkcija za Poljoprivredu i Ruralni Razvoj / Directorate for Agriculture and Rural Development

Data/Datum/Date:	07.05.2024
Nr./Br./No.	12/04
Nga/Od/From:	Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural: Gojart Bajrami
Lënda/Predmet/Subject:	Thirrje për aplikim

Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, duke u bazuar në Nenin 61, Paragrafi 62.3 i Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nenin 5, paragrafin 5.1 dhe 5.2, Neni 19, Paragrafi 19.1, 19.2.4, të Rregullores Nr. 01-060/01-24495/17 për Ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve bënë këtë:

Thirrje për aplikim

Ftohen fermerët kultivues të drithërave të bardha (Misër) dhe kultivues të perimeve në serra dhe në fushë të hapur, për aplikim:

1. Kultivues të drithërave të bardha - misrit,
2. Kultivues të perimeve në serra dhe fushë të hapur,

Kriteret që duhet të plotësoj aplikuesi janë:

- Të jetë banorë rezident i Komunës së Shtimes
- Aplikues për subvencione (pagesa direkte) për vitin 2024

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Kopja e dokumentit identifikues të Republikës së Kosovës,
- Formulari për aplikim në subvencione 2024 - kopje,
- Konfirmimi bankar – kartela e bankës kopje,
- Dëshmia e pagesës së tatimit në pronë,
- Aplikacioni i plotësuar.

Afati për aplikim: 07 Maj 2024 – 24 Maj 2024

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën pritëse.